

Në bazë të nenit 146 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Konkluzionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë numër 07-5588/13 të miratuar në seancën e mbajtur më 30 dhjetor 2008, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2009 i miratoi këto

KONKLUZIONE:

- 1) Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarim, jepet në diskutim publik.
- 2) Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të përmbarim bashkë me këto konkluzione, do të botohen në gazetat “Dnevnik”, “Shpic”, dhe “Lajm”.
- 3) Thirren qytetarët, institucionet publike, institucionet, shoqatat e qytetarëve, partitë politike, sindikatat dhe subjektet e tjera të interesuara, që mendimet dhe propozimet e tyre për Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarim t’ia drejtojnë drejtpërsëdrejti Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 11 maj 2009 (e hënë).
- 4) Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e përcjell diskutimin publik, i mbledh dhe i rregullon mendimet dhe propozimet e shprehura dhe përgatit raport për rezultatet e diskutimit publik dhe të Propozim-ligjit për leximin e dytë.

KRYETAR

**i Komisionit për sistem politik dhe
marrëdhënie ndërmjet bashkësive
Zoran Petreski**

2009

Shkup

**Republika e Maqedonisë
MINISTRIA E DREJTËSISË**

**PROPOZIM-LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR PËRMBARIM**

Shkup, dhjetor 2008

HYRJE:

I. VLERSIMI I GJENDJEVE NË LËMIN QË DUHET TË RREGULLOHET ME LIGJ DHE ARSYET PËR MIRATIMIN E LIGJIT

Ligji për përmbarim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2005, 50/2006, 129/2006 dhe 8/2008) duke filluar nga 26.5.2006 tërësisht e ndryshoi sistemin e përmbarimit të vendimeve gjyqësore që vijnë në përbushjen e obligimeve, vendimeve të miratuara në procedurën administrative që vijnë në përbushjen e obligimit me të holla dhe përmbarimin e shpenzimeve gjyqësore dhe shqiptimin e dënimit procedurat kontestimore, për kundërvajtje, penale dhe administrative. U lëshua sistemi i përmbarimit gjyqësor, dhe përmbarimi u orientua drejt përmbaruesve - persona privat të cilët kryejnë autorizime publike të emëruara në përputhshmëri me Ligjin.

Rezultatet nga sistemi tillë i përmbarimit janë të shkëlqyeshme kurse gjendjen me vëmendje e ndjekin shumë organizata ndërkombëtare cilat japin gjithnjë e më tepër vlerësime të volitshme për gjendjet ekonomike në vend para se gjithash nga aspekti i investimeve të huaja dhe mbrojtja e tyre juridike në Republikën e Maqedonisë.

Përqindjet e lëndëve përmbaruese rriten vazhdimisht. Kështu derisa përqindja e lëndëve përmbaruese në vitin 2007 mesatarisht ishte 40%, ajo në janar 2008 ishte 46%, shkurt 51%, maj 47%, qershor dhe korrik 51%, në gusht arriti 71% dhe në shtator 45%. Përqindja e tillë e realizimit, theksojmë se zhvillohet në kuadër të disa afateve mujore te përmbaruesit privat, e jo pas disa veprimeve vjetore para gjykatave të cilat rezultuan me përqindje të përmbarimeve të realizuara më të ulët se 20%. Në Republikën e Maqedonisë në 2007 shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara të përmbarimit nga ana e përmbaruesve është 3.003.946.266,06 denarë ose 48.973.066,22 EURO. Në 2008 përfundimisht më 10.10.2008 shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara të përmbarimit nga ana e përmbaruesve është 2.416.488.007,78 denarë ose 39.356.482.21 EURO. Në Republikën e Maqedonisë momentalisht punojnë 54 përmbarues. Në zyrat e përmbaruesve punojnë gjithsej 180 të punësuar nga të cilët 35 zëvendës, 40 ndihmës, bashkëpunëtorë profesional dhe personel tjetër profesional dhe tekniko-administrativ. Me sistemin e ri të përmbarimit shteti nuk ka kurrfarë shpenzimi në bazë të pagave për administratë në gjykatat, as për sigurimin e hapësirave, pajisjeve dhe mjeteve për punë. Në këtë mënyrë zvogëlohet aparati shtetërorë dhe shteti realizon të hyra nga përmbaruesit nëpërmjet pagesës së tatimeve (personale, tatimit të vlerës së shtuar dhe tatimit të fitimit). Në arkën shtetërore vetëm në bazë të TVSH së paguar në 2007 janë grumbulluar 1.055.374 EURO, kurse në bazë të tatimit personal 48.351 EURO.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim nga 26.5.2006, gjykatat nuk kanë bazë të pranohet propozime të reja për përmbarim të kreditorëve,

kurse në pajtim me nenin 238 nga Ligji, procedurat për përmbarrim të filluara para gjykatave në Republikën e Maqedonisë deri në ditën e zbatimit të këtij ligji vazhduan që të realizohen në gjykata sipas Ligjit për procedurë përmbarruese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 53/97, 59/2000 dhe 64/2003), përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2008. Domethënë, gjykatave u janë lënë gjithsej dy vjet e gjysmë, periudhë në të cilën priteshe që ato ti finalizojnë procedurat përmbarruese veç më të filluara meqë pas skadimit të asaj date nuk ka më bazë ligjore që të vazhdohet përmbarrimi në gjykata.

Për këtë qëllim Ministria e Drejtësisë periudhën e kaluar vazhdimisht i ndiqte të dhënat me lëndët përmbarruese në gjykata, meqë ishte e sigurt se një numër i caktuar i lëndëve ne gjykata do të mbetet i pambaruar dhe se duhet të mendohet më mirë në transferimin e tyre tek përmbarruesit.

Të dhënat statistikore me cilat disponon Ministria e Drejtësisë, ndërsa të përgatitura në bazë të raporteve për punë të cilat i parashtrajnë gjykatat, theksuan në faktin se numri më i madh i gjykatave vazhdimisht tregojnë rezultate ekstreme të dobëta në bazë të lëndëve të realizuara përmbarruese, me qëllim që numri i lëndëve të pakryera përmbarruese të arrijë 339.608.

Gjegjësisht, ndodhi diçka e papritur. Para se gjithash për shkak të organizimit jo të mirë të punës në gjykata të caktuara, seksionet e përmbarruara tërësisht u pasivizuan – gjykatësit përmbarrues me përvojë u sistemuan sipas seksioneve tjera, kurse në vendet e tyre u sistemuan gjykatës të porsaemëruar, ose gjykatës pa asnjë lloj përvojë në lëmin e përmbarrimit. Në situatë kur nuk kishte kohë për adaptimin e tyre të detyrave të reja përmbarruese, përmbarruesit gjyqësorë të cilët në tërësi të veprimit janë të varur nga gjykatësit përmbarrues, u lanë vetës dhe e gjithë kjo rezultoi me jozbatim ekstrem në lëmin e përmbarrimit.

Ministria e Drejtësisë e ballafaquar me sfidën që ta krijojë transferimin e atyre lëndëve përfundimtare të cilat do të mund të barten te përmbarruesit që nga fillimi i shkurtit 2008, filloi me përgatitjet për analizën e lëndëve përmbarruese të cilat gjenden në gjykata. Filloi me analizën e të dhënave statistikore të cilat gjykatat ia parashtrajnë Ministrisë së Drejtësisë dhe menjëherë konstatohet se gjendja e tillë e lëndëve as për së largu nuk i përshtatet gjendjes reale me lëndët përmbarruese te ato.

Gjegjësisht, Gjykata Themelore - Shkup 2 në raportet e sajë vite me radhë përfundimisht me 31.8.2008 paraqet numër prej 40 mijë lëndë, edhe pse e din që vetëm një kreditor (EVN) në të njëjtën gjykatë ka numër madhështorë të lëndëve të përmbarruara. Numri i lëndëve nga ndërmarrjet tjera komunale në Shkup akoma është i panjohur për Ministrin e Drejtësisë. Gjykata Themelore - Shkup 2 përfundimisht me 15.11.2008 e saktëson numrin e përgjithshëm të lëndëve përmbarruese në punën para gjykatës së 319.175 lëndëve, prej të cilave vetëm 4.671 janë lëshuar në bazë të akt-dënimeve gjyqësore, përderisa pjesa e mbetur e lëndëve sipas dokumenteve autentike nga ndërmarrjet komunale (EVN, Ujës-jellësi, ngrohtorja...). Megjithatë kreditori më i madh është EVN numri i lëndëve i të cilit e tejkalon numrin prej 186.000. Kjo gjykatë nuk bën përjashtim dhe gjendja e tillë përsëritet pothuajse në të gjitha gjykatat në vend.

Ministria e Drejtësisë, e ballafaquar me njohjet e tilla dështuese, kurse nga ana tjetër përpjekja për krijimin e sistemit efikas të shpërndarjes së

mjeteve te përmbaruesit, ballafaqohet me nevojën për shqyrtimin e situatës reale me lëndët e përmbaruara në secilën nga gjykatat.

Për realizimin e qëllimit të verifikuar, Ministria e Drejtësisë me përkrahje të pafund dhe të pazezruar të Projektit për implementimin e reformave në jurisprudencë/USAID, të cilën e përkrah dhe ndihmon Ministria e Drejtësisë nga vetë fillimi i reformës së përmbaruar në Republikën e Maqedonisë, filloi procesi i skenimit të lëndëve përmbaruese. Me procesin e skenimit Ministria e Drejtësisë krijoi mënyrë tërësisht të re të analizimit të lëndëve përmbaruese në gjykata, që mundësoi marrjen e fotografisë reale për numrin e përgjithshëm dhe strukturën e lëndëve përmbaruese në të njëjtat. Kjo para së gjithash nevojitej për shkak të saktësisë të numrit të lëndëve që do të duhej të transferohen te përmbaruesit, krijimit të sistemit të transferimit, shmangies së ngarkesës së dyfishtë të kreditorëve me avancimin e shpenzimeve të përmbarimit dhe të ngjashme.

Të dhënat nga kjo analizë e theksuan situatën vijuese:

- Numri i përgjithshëm i lëndëve përmbaruese e tejkalon numrin 658.000 lëndë. Përdoret termi "e tejkalon" për arsye se është shënuar rritje e vazhdueshme e lëndëve përmbaruese në Gjykatën Themelore-Shkup 2, Shkup. Kjo i përket "gjallërimit" të përhershëm përkatësisht riaktivizimit të lëndëve tanimë të arkivuara nga ana e Gjykatës Themelore-Shkup 1. Numri i lëndëve për të cilat mund të pritet që të riaktivizohen për përmbarim është i panjohur për shkak të mospasjes së të dhënave valide nga Gjykata Themelore-Shkup 1 në momentin e transferimit të lëndëve në prill 2007 që kryhet për shkak të kompetencës së ndryshuar reale.
- Numri i lëndëve përmbaruese në bazë të vendimit gjyqësor të marrë në procedurë kontestuese arrin 25.434 lëndë ose 11% nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pambaruara .
- Numri i lëndëve përmbaruese për kundërvajtje dhe penale është i ndryshëm për çdo gjykatë për shkak të qasjes së ndryshme për evidentimin dhe ndjekjen e tyre. Gjegjësisht gjykatat e caktuara duke ia parashtruar lëndën Avokatit Shtetëror të RM-së për inicimin e përmbarimit, lëndën e konsiderojnë të mbaruar dhe të njëjtën e arkivojnë, për shkak se në raporte nuk paraqesin numër të lëndëve përmbaruese në këtë bazë . Ndërkaq gjykatat tjera lëndët e tilla i kryesojnë në evidencat e tyre dhe e ndjekin përmbarimin e tyre deri në momentin e pagesës të dënimit kundërvajtës/sanksionit.

Të dhënat e parashtruara vënë në dukje se numri i këtyre lëndëve lëviz rreth 12% .

- Një numër i madh i lëndëve, rreth 77% bie në dokumentet autentike. Përqindja e lëndëve që kanë të bëjnë me dokumentet autentike të cilat njëkohësisht e kanë statusin e dokumenteve përmbaruese (ishin të parashtruara në rregull dhe u bënë të plotfuqishme) që në pajtim me Ligjin për përmbarim është i ndryshëm dhe ndryshon nga gjykata në

gjykatë. P.sh. në gjykatat themelore Prilep, Kumanovë dhe Gostivar përqindja është rreth 35%, Gjykata themelore -Tetovë 16%, që në Gjykatën Themelore - Shkup 2 kjo përqindje lëviz rreth 18% .

- Numri i lëndëve ndaj dokumentit autentik për të cilat kreditorët i kanë paguar taksat gjyqësore, e tejkalon numrin 306.386 mijë, dhe në krahasim me numrin e përgjithshëm të lëndëve të përmbaruara deri më tani të evidentuara arrin 46%.

Vetëm të dhënat nga EVN Shkup, si kreditor më i madh në shtet, të përpunuara nga Projekti, theksojnë se taksat janë paguar sipas të gjitha propozimeve për përmbarim. Por megjithatë përqindja e dokumenteve autentike të pambaruara te ato e tejkalon përqindjen prej 81%. Kjo ka të bëjë me faktin se dokumentet e tilla në përgjithësi nuk i janë parashtruar debitorëve vite me radhë , kurse në lëndën përveç një ekzemplari të shtypur të Propozimit për përmbarim nuk ka asgjë tjetër. Problem të madh paraqet fakti që EVN (pjesë e ESM-së së mëparshme), por edhe ndërmarrjet tjera komunale u lanë vetë më vete që ta zbatojnë procedurën përmbaruese 20 vite me radhë. Nëse më herët arsyetimi ka qenë i kërkuar me atë që bëhej fjalë për ndërmarrje publike, është fakt se ndërmarrjet komunale veç më kanë kaluar në pronësi private - disa prej tyre edhe në persona të huaj, që delegimin e mëtejme të kompetencës gjyqësore te të njëjtit e bën të palejuar.

Ministria e Drejtësisë e ballafaquar me sfidën për krijimin e sistemit për bartje efikase të lëndëve të përmbaruara nga gjykatat te përmbaruesit vitin e kaluar vazhdimisht bashkëpunuan me gjykatat me qëllim që tu vë në dukje seriozitetin e këtij procesi, si dhe nevojën për analizë serioze të lëndëve që gjenden te ata. Me ç'rast u theksua se te përmbaruesit do të mund të barten vetëm ato lëndë të cilat i plotësojnë kushtet për përmbarim sipas Ligjit për përmbarim. Vetëm ato dokumente autentike të cilat kanë mbetur të plotfuqishme dhe përmbaruese nga 26.5.2006 do të mund të dorëzohen te përmbaruesit. Parashtrimi nuk do të zhvillohet thjeshtë me bartjen e rëndomtë fizike të lëndëve, por transferimi i lëndëve të përmbaruara do të rregullohet me ligj duke e respektuar vullnetin e kreditorëve , meqë ata janë të autorizuar që ta zgjedhin përmbaruesin e tyre .

Është e domosdoshme që të shqyrtohet se si është statusi me pagesën e taksës gjyqësore te lëndët e përmbaruara lidhur me dokumentin autentik të cilat u përmbaruan dhe u përfunduan, por edhe te ato lëndë lidhur me dokumentet përmbaruese si dhe te lëndët penale dhe për kundërvajtje, si dhe shumat të cilat janë grumbulluar në këtë bazë. U është theksuar në nevojën për riorganizim urgjent të punës në gjykata. Gjegjësisht seksionet përmbaruese në vend që të shpërndahen, është e nevojshme që menjëherë të përforcohen më gjykatës të cilët mund të ballafaqohen me analizën e lëndëve përmbaruese, si do të mundësohej bartje sa më e shpejtë e lëndëve përmbaruese nga gjykatat te përmbaruesit.

Nga analizat të cilat i zbatoi Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Projektit për reforma në jurisprudencë-USAID u imponua nevoja për lehtësimin e gjykatave nga lëndët lidhur me urdhërpagesa. Për këtë qëllim në Ligjin për përmbartim jepen dispozitat për veprimin e noterëve lidhur me propozimin për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik.

II. QËLLIME, PARIME DHE ZGJIDHJE THEMELORE

Qëllimi i zgjidhjeve të propozuara ligjore është krijimi i sistemit për bartjen efikase dhe efektive të lëndëve përmbartuese nga gjykatat te përmbartuesit privat dhe lehtësimin e gjykatave nga propozimet për dhënien e urdhërpagesave në bazë të dokumentit autentik.

Në bazë të bartjes së lëndëve përmbartuese nga gjykatat te përmbartuesit privat, mbahet llogari që të mos dëmtohen kreditorët procedurat e të cilëve kanë filluar në gjykata para disa vjetësh, kurse lëndët e të cilëve jo me fajin e tyre nuk mund në mënyrë të drejtpërdrejtë që të kalojnë te përmbartuesit - për arsye të statusit të ndryshuar të dokumenteve përmbartuese .

Njëkohësisht mbahet llogari edhe për të drejtat e debitorëve të cilët në procedurën përmbartuese pranë gjykatave i ngadalësojnë veprimet e ndërmarra përmbartuese- mjetet juridike të investuara për të cilat procedurat në gjykata akoma janë në rrjedhë.

Me plotësimet ligjore të propozuara vendoset kompetencë e deleguar gjyqësore te noterët me qëllim që të mundësohet që në afat sa më të shkurtër lëndët përmbartuese të cilat nuk janë arritur me statusin fuqiptotë dhe përmbartues, ta fitojnë atë status, me çka përmbartimi të kalojë te përmbartuesi.

Kjo zgjidhje imponohet si domosdoshmëri nga një arsye e thjeshtë, se gjykatat nuk arrijnë që ta sigurojnë këtë status fuqiptotë dhe përmbartues vite me radhë, jo për fajin e kreditorëve, por për shkak të problemeve organizative në gjyqësi.

Njëkohësisht është verifikuar obligimi i institucioneve të cilat i mbajnë librat publik të veprojnë sipas konkluzioneve të përmbartuesve, pavarësisht faktit se regjistrimi inicial në librat është kryer nga ana e gjykatave ose subjekteve tjera të autorizuara me ligj. Duke marrë parasysh parashtrimin, është tërësisht e qartë se procedura e gjykatave në lëndët përmbartuese nuk mund të ndërpresë më 31.12.2008, për shkak se dispozita ligjore në të cilën është verifikuar ky afat është shlyer. I domosdoshëm është veprimi i më tejme i gjykatave në lëndët të cilat gjenden në procedurë sipas mjetit juridik, si dhe ndërmarra e veprimeve për analizën dhe përgatitjen e lëndëve të tyre për bartje te përmbartuesit me kërkesë të kreditorëve.

Me dispozitat të cilat i dedikohen veprimit të noterëve në lidhje me propozimet për miratimin e aktvendimit, me të cilën lejohet zbatimi në bazë të dokumentit autentik, do të mundësohet veprim efikas i gjykatave ndaj lëndëve të cilat paraqesin kompetencë reale gjyqësore, gjegjësisht lëndëve kontestuese.

III. VLERËSIMI I PASOJAVE FINANCIARE NGA PROPOZIM-LIGJI MBI BUXHETIN DHE MJETET TJERA FINANCIARE PUBLIKE

Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarim nuk paraqet implikime financiare mbi Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

IV. VLERËSIMI I MJETEVE FINANCIARE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E LIGJIT, MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE DHE TË DHËNAT PËR ATË NËSE ZBATIMI I LIGJIT TËRHEQ DETYRIME MATERIALE PËR SUBJEKTE TË VEÇANTA

Për zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara nuk është i nevojshëm sigurimi i mjeteve financiare.

V. LIGJE QË DUHET NDRYSHUAR DHE QË DALIN NGA MIRATIMI I KËTIJ LIGJI

Miratimi i Propozim–ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përmbarim duhet te nxirret në pako me ndryshimet e Ligjit për procedurë kontestuese, për arsye të rregullimit të procedurës për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumenteve autentike.

**PROPOZIM-LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR PËRMBARIM**

Neni 1

Në Ligjin për përmbarim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, numër 35/2005, 50/2006, 129/2006 dhe 8/2008) në nenin 1 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në bazë të përmbarimit të detyrueshëm të dokumenteve të noterit dhe dokumenteve tjera përmbaruese të parapara me ligj."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 2

Në nenin 2 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Bazë për përmbarim është edhe aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik të lëshuar nga noteri".

Paragrafët (2), (3) dhe (4) bëhen paragrafë (3), (4) dhe (5).

Neni 3

Në nenin 12 në paragrafin (1) pas pikës 3-a lidhëza "dhe" shlyhet dhe shtohet pikë e re 3-b si vijon:

"3-b Aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik të lëshuar nga noteri dhe."

Neni 4

Në nenin 16 pas paragrafit (1) shtohet paragrafi (2) si vijon:

"(2) Aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik të lëshuar nga noteri bëhet dokument përmbarues me vënien e vërtetimit për plotfuqishmëri dhe përmbarim nga noteri."

Paragrafi (2) bëhet paragrafi (3).

Neni 5

Pas nenit 16 shtohen tetë tituj të rinj dhe tetë nene të reja 16-a,16-b,16-v,16-g,16-d,16-gj,16-e dhe 16-zh, si vijon:

"Procedura për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik

Neni 16-a

Propozimi për marrjen e aktvendimit për leje për përmbarim në bazë të dokumentit autentik kreditori ia dorëzon noterit me zgjedhjen e tij në rajonin e

të cilit është vendbanimi, gjegjësisht vendqëndrimi i debitorit - person fizik, gjegjësisht selia e debitorit - person juridik.

Përmbajtja e propozimit

Neni 16-b

Propozim për marrjen e aktvendimit për leje për përmbartim në bazë të dokumentit autentik të kreditorit përmban kërkesë për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik, si dhe të dhëna për: kreditorin, debitorin, kërkesën, llojin, vëllimin, kohën e realizimit të obligimit dhe maturimit të saj.

Baza për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik

Neni 16-v

(1) Propozim për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik parashtrohet për kërkesën e maturuar me para që vërtetohet me dokument autentik ndaj propozimit në origjinal ose të verifikuar te noteri.

(2) Dokumenti autentik sipas këtij ligji është: fatura, kambiali dhe çeku me protestë dhe me llogari kthyese, kur kjo është e nevojshme për formimin e kërkesës, dokumentit publik, ekstraktit nga librat zyrtarë të verifikuar, dokumentit autentik të verifikuar sipas ligjit dhe dokumenteve të cilat sipas rregullave të veçanta kanë rëndësinë e dokumentit publik. Si faturë llogaritet dhe llogaria e kamatës.

(3) Në aktvendimin me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik duhet të jetë i theksuar kreditori, debitori, kërkesa, lloji, vëllimi dhe koha e plotësimit të obligimit.

(4) Nëse nga dokumenti autentik nuk shihet se kur maturon kërkesa, noteri do të marrë aktvendim me të cilin lejohet përmbartimi nëse kreditori parashtron deklaratë me shkrim se ka maturuar kërkesa edhe pse e ka shënuar ditën e maturimit.

Veprimi ndaj propozimit për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik

Neni 16-g

(1) Nëse noteri vlerëson që propozimi për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik lejohet dhe është me bazë, do të marrë aktvendim me cilin lejohet përmbartimi në bazë të dokumentit autentik dhe do t'ua dorëzojë palëve.

(2) Nëse noteri vlerëson që propozimi për marrjen e aktvendimit me cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik lejohet ose nuk ka bazë, do t'ia ridrejtojë lëndën gjykatës kompetente për veprim dhe vendosje të mëtejme sikur është parashtruar padi.

(3) Nëse noteri vlerëson që propozimi për marrjen e aktvendimit me cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik nuk është rregulluar, do t'ia kthejë kreditorit ta rregullojë sipas drejtimeve të dhëna në afat prej 8 ditësh prej ditës së pranimit të lajmërimit. Nëse kreditori nuk e dorëzon propozimin në afatin e caktuar, propozimi do të konsiderohet si i tërhequr.

(4) Nëse kreditori e dorëzon propozimin, ndërsa propozimi nuk është i rregulluar në pajtim me drejtimitet e dhëna, propozimi do të hedhet poshtë me aktvendim, kundër të cilit lejohet ankesë në afat prej tetë ditësh te gjykata themelore kompetente në rajonin e të cilit është selia e noterit te cili është dorëzuar propozimi.

Kundërshtim ndaj aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik

Neni 16-d

(1) Debitori mund t'i dorëzojë kundërshtim kundër aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik noterit i cili e ka marrë aktvendimin, në afat prej tetë ditësh prej ditës së pranimit të aktvendimit.

(2) Noterit të cilit i është parashtruar kundërshtimi pas kalimit të afatit (jo në kohë), i parashtruar nga personi i paautorizuar ose personi që nuk ka interes juridik për dorëzimin e ankesës (e palejueshme), e paqartë, e panënshkruar, pa mundësi që të caktohet për cilin aktvendim bëhet fjalë (jo i plotë) kundër aktvendimit të cilin ai e ka marrë, do të marrë aktvendim për hedhjen poshtë të kundërshtimit të tillë.

(3) Noteri te i cili është parashtruar kundërshtimi me kohë dhe i lejuar kundër aktvendimit të cilin e ka marrë, do t'ia dorëzojë shkresat gjykatës themelore në rajonin e së cilës është selia e noterit te i cili është parashtruar kundërshtimi për zbatimin e procedurës me rastin e kundërshtimit dhe marrjes së vendimit në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore për veprim në bazë të kundërshtimit për urdhërpagesë.

Vërtetim për plotfuqishmëri dhe përmbarim

Neni 16-gj

(1) Noteri do të vë vërtetim për plotfuqishmërinë dhe përmbarimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi nëse në afat prej tetë ditësh nuk pranon kundërshtim, gjegjësisht kundërshtimin e ka hedhur poshtë si jo në kohë ose të palejueshëm.

(2) Aktvendimin me të cilin lejohet përmbarimi me vërtetim për plotfuqishmëri dhe përmbarim noteri do të ia dorëzojë kreditorit.

E drejta e noterëve për shpërblim dhe kompensim të harxhimeve

Neni 16-e

(1) Për kryerjen e punëve nga procedura për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi, noterët kanë të drejtë për shpërblim dhe kompensim të harxhimeve në pajtim me Rregulloren për tarifë noteriale.

(2) Shpërblimi dhe kompensimi i harxhimeve të cilat debitori do t'ia paguajë noterit, janë pjesë e harxhimeve për përmbarimin. Noteri është i detyruar që debitorit t'i japë llogari për shpërblimin dhe harxhimet.

Obligimi për pagesën e taksës gjyqësore

Neni 16-zh

Në procedurën për marrjen e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi, si dhe ndaj kundërshtimit kundër aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik paguhet taksë gjyqësore në pajtim me Ligjin për taksat gjyqësore të zvogëluar në bazë të Ligjit për noterit."

Neni 6

Në nenin 238, paragrafi 1 presja zëvendësohet me pikë dhe fjalët: "më së voni deri më 31.12. 2008" shlyhen.

Neni 7

Kreditorët që kanë filluar procedurë për përmbarim para gjyqeve deri më 26. 05.2006 dhe për të cilat është marrë aktvendim i plotfuqishëm për përmbarim në gjyq, janë të obliguar që afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji t'i parashtrojnë deklaratë gjyqit para të cilit mbahet procedura ekzekutive, cilit ekzekutues t'i dorëzohet lënda dhe në çfarë sasive është e mbuluar kërkesa në mënyrë që ekzekutuesi të mund ta vazhdojë ekzekutimin.

Neni 8

(1) Për lëndët për të cilat është paraqitur mjet juridik, afati për gjashtë muajsh, i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, fillon të rrjedhë nga dita e pranimit të vendimit sipas mjetit juridik nga ana e kreditorit me të cilin është refuzuar mjeti juridik.

(2) Nëse mjeti juridik është pranuar, afati prej gjashtë muajsh i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, fillon të rrjedhë prej ditës së marrjes së vendimit sipas mjetit juridik nga ana e kreditorit, kurse procedura vazhdon para ekzekutuesit, i cili është i obliguar të veprojë sipas udhëzimeve nga gjykata më e lartë, në pajtueshmëri me autorizimet e ekzekutuesit nga neni 40 i Ligjit për përmbarim.

Neni 9

(1) Kreditori i cili nuk do të veprojë në pajtim me nenet 7 dhe 8 nga ky ligj, do të konsiderohet se e ka tërhequr propozimin për ekzekutim, për çka gjyqi do të marrë aktvendim kundër të cilit lejohet ankesë në afat prej tetë ditësh.

(2) Gjykata së cilës i është deklaruar ankesë, është e detyruar që në afat prej tre ditësh nga dita e pagesës së taksës gjyqësore t'ia dorëzojë lëndën gjykatës së apelit, e cila duhet të vendosë për ankesën në afat prej 15 ditësh.

Neni 10

Me bartjen e lëndëve ekzekutuese prej gjykatave tek ekzekutuesit, afati për parashkrim ndërpritet.

Neni 11

(1) Gjatë pranimit të lëndës ekzekutuese, ekzekutuesi e pranon lëndën në atë stadium në të cilin ka qenë para gjykatës. Veprimet ekzekutuese të ndërmarra nga gjykata kanë vlerë juridike sikur i ka marrë ekzekutuesi i cili e vazhdon ekzekutimin.

(2) Pas pranimit të lëndës ekzekutuese është i obliguar ta informojë debitorin se ekzekutimi i filluar para gjykatës vazhdon te ekzekutuesi.

(3) Kur kreditori do të japë deklaratë para gjykatës për zgjedhjen e ekzekutuesit, gjykata është e obliguar t'i nënshkruajë të gjitha veprimet e ndërmarra, shkresat të cilat gjenden në lëndën gjyqësore dhe shpenzimet e paguara nga gjykata, të miratojë konkluzion për t'ia dorëzuar lëndën ekzekutuesit dhe lëndën t'ia dorëzojë ekzekutuesit të caktuar nga kreditori në afat prej tetë ditësh.

Neni 12

(1) Shpenzimet për të cilat ekziston argument se janë paguar në gjykatë i pranohen kreditorit, kurse ekzekutuesi është i obliguar t'i paguajë nga debitori dhe t'ia bartë kreditorit.

(2) Detyrimi për pagesën e çmimit për administrim për ato lëndë në të cilat ekziston argument se kreditorët e kanë paguar taksën gjyqësore, bien në barrë të debitorit.

Neni 13

(1) Propozimet për përmbarim të parashtruara para 26.05.2006, të cilat nuk janë të plotfuqishme dhe propozimet për përmbarim të parashtruara në bazë të dokumenteve të besueshme, për të cilat nuk është marrë aktvendim i plotfuqishëm për përmbarim, gjykata i dorëzon në veprim te noteri i cili vepron si i besuar i gjykatës.

(2) Noteri ia dorëzon aktvendimit për përmbarim debitorit me këshillë juridike se në afat prej tetë ditësh ka të drejtë kundërshtimi nëpërmjet noterit gjykatës, e cila e ka kaluar lëndën.

(3) Kur kundërshtimi nuk është në kohë, i ndaluar dhe jo i plotë, noteri e hedh poshtë me aktvendim ndaj të cilit lejohet ankesë në afat prej tetë ditësh e cila e ka kaluar lëndën.

(4) Nëse noteri nuk e hedh poshtë kundërshtimin, lënda dorëzohet në gjykatë dhe procedura vazhdon sikur ndaj padisë për kundërshtim për dhënien e fletëpagesës.

(5) Për procedurat për të cilat nuk është deklaruar kundërshtim, pas skadimit të afatit të paraparë, noteri jep vërtetim për plotfuqishmëri dhe përmbarim, dhe aktvendimin ia dorëzon kreditorit me sqarim se fillon të rrjedhë afati nga neni 7 i këtij ligji.

Neni 14

(1) Aktvendimi përmbarues i marrë nga gjykata në bazë të dokumentit të besueshëm, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe përmbarues, merr cilësinë e dokumentit përmbarues për pagesë të kërkesës në para.

(2) Kreditori në afatin e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, është i detyruar të marrë pjesë para gjykatës dhe të kërkojë që ai të japë vërtetim për plotfuqishmëri dhe përmbarim.

Neni 15

Subjektet të cilat mbajnë librat dhe regjistra publikë janë të detyruar të veprojnë në pajtim me konkluzionin e përmbaruesit që e vazhdon përmbarimin, për fshirjen apo ndryshimin e të dhënave të vendosura në to në bazë të aktvendimit gjyqësor.”

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

ARSYETIMI I PROPOZIM-LIGJIT

I. SHPJEGIMI I PËRMBAJTJES SË DISPOZITAVE TË PROPOZIM-LIGJIT

Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarim është sistematizuar në 16 nene ligjore. Me nenin 1 parashihet se dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj përmbarimit të detyrueshëm të dokumenteve të noterit dhe dokumenteve tjera përmbaruese të parapara me ligj.

Me nenin 2 parashihet se baza e përmbarimit është edhe aktvendimi me të cilin lejohet përmbarim në bazë të dokumentit autentik të miratuar nga noteri.

Me nenin 3 parashihet se dokument përmbarues është edhe aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik të miratuar nga noteri.

Në nenin 4 i cili i dedikohet përmbarimit të dokumentit të noterit verifikohet se aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik të miratuar nga noteri bëhet dokument përmbarues me vënien e vërtetimit për plotfuqishmëri dhe përmbarim nga notari.

Gjithë këto nene janë rezultat i përpjekjes që të zvogëlohet numri i lëndëve në gjykatë të cilat nuk janë kontestuese dhe tek të cilët mund të bartet kompetenca e personave të cilët kryejnë autorizime publike përkatësisht të noterëve.

Me nenin 5 shtohen tetë tituj të rinj dhe tetë nene të reja pas nenit 16 me të cilët rregullohet procedura për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik me parashtrimin e propozimit, te noteri sipas zgjedhjes së tij në rajonin e të cilit është vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi i obliguesit-personit fizik, përkatësisht selinë e personit juridik-obligues nga kreditori. Në nenet rregullohet përmbajtja e propozimit, bazë për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik dhe veprimi sipas propozimit për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik nga noteri. Me nenet e reja rregullohen edhe kundërshtimi kundër aktvendimit të miratuar nga noteri, vërtetimi për plotfuqishmëri dhe përmbarim të aktvendimit, si dhe e drejta e noterëve për shpërblim dhe kompensim të shpenzimeve dhe obligimi për pagesën e taksës gjykatëse.

Me nenin 6, shlyhet afati për veprim nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë të vërtetuar në nenin 238 paragrafi 1 me çka krijohet mundësia që gjykatat t'i kryejnë procedurat të cilat sipas mjeteve juridike gjenden para tyre, si dhe t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe analizat për bartjen e mjeteve te përmbaruesit.

Në nenet prej 7 deri 16 nga dispozitat kalimtare të Ligjit për përmbarim, me nenin 7 obligohen kreditorët që kanë filluar procedurë për përmbarim pranë gjykatave të Republikës së Maqedonisë deri më 26.5.2006 dhe për të cilat është miratuar aktvendim i plotfuqishëm për përmbarim në gjykatë, në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji t'i parashtrojnë deklaratë gjykatës para të cilit mbahet procedura përmbaruese, te cili përmbarues të dorëzohet lënda dhe në cilin vëllim është përmbushur kërkesa, që përmbaruesi të mund ta vazhdojë përmbarimin.

Me nenin 8 rregullohet fillimi i rrjedhjes së afatit për lëndët për të cilat është deklaruar mjet juridik.

Me nenin 9 është vërtetuar se i kreditori i cili nuk do të veprojë në pajtim me detyrimin e verifikuar në nenet 7 dhe 8, do të konsiderohet se e ka tërhequr propozimin për përmbarrim.

Me nenin 10 është vërtetuar se me bartjen e lëndëve përmbarruese nga gjykatat të përmbarruesit afati për vjetërsim skadon.

Me nenin 11 definohet stadiumi i lëndës përmbarruese në të cilën lënda bartet të përmbarruesi në veprim të mëtutjeshëm.

Në nenin 12 është e paraparë që shpenzimet për të cilat ekziston dëshmi se janë paguar në gjykatë ti njihen kreditorit, dhe përmbarruesi është i obliguar që t'i paguaj nga debitori dhe t'i bartë kreditorit, ndërsa obligimin për pagesën e çmimit për administrim sipas atyre lëndëve në të cilat ekziston dëshmi se kreditorët e kanë paguar taksën gjyqësore, bien në barrë të debitorit.

Me nenin 13 rregullohet veprimi, propozimet për përmbarrimin të parashtruara para 26.5.2006 të cilat nuk janë fuqiptotë dhe propozimet për përmbarrim të parashtruara në bazë të dokumenteve autentike, për të cilat nuk është miratuar aktvendim fuqiptotë për përmbarrim, gjykata i dorëzon për procedim noterit i cili vepron si i besueshëm në gjykatë.

Në nenin 14 është rregulluar arritja e statusit të plotfuqishmërisë dhe përmbarrimit të aktvendimit përmbarrues të miratuar nga gjykata në bazë të dokumentit autentik.

Me nenin 15 definohet detyrimi i subjekteve juridike të cilat mbajnë libra publik dhe regjistra të vepron në pajtim me konkluzionin e përmbarruesit i cili e vazhdon përmbarrimin, pavarësisht faktit se vërejtjet dhe regjistrimet janë vendosur nga ana e gjykatës.

Me nenin 16 rregullohet data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve të miratuara.

II. NDËRLIDHJA RECIPROKE E ZGJIDHJEVE TË PËRMBAJTURA NË DISPOZITAT E PROPOZUARA

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në këtë propozim-ligj janë të lidhura ndërmjet vete dhe i dedikohen bartjes së lëndëve të përmbarduara nga gjykatat te përmbarduesit. Ky proces u anulua nga 2005 me qëllim që të krijohen kushte për bartje efikase dhe efektive.

III. PASOJAT E DALA NGA ZGJIDHJET E PROPOZUARA

Me zgjidhjet ligjore të propozuara do të fillohet proces i zvogëlimit të numrit të lëndëve që gjenden para gjykatave të RM-së të cilat vite me radhë e ngarkojnë gjyqësi maqedonase. Nëse merret parasysh se lëndët përmbarduese paraqesin rreth 70% të numrit të përgjithshëm të lëndëve para gjykatave maqedonase, për pritje është se me procedurën për bartjen e lëndëve të vjetra përmbarduese nga gjykatat te përmbarduesit do të mundësohet krijimi i kushteve për veprim efikas ndaj lëndëve të cilat përfaqësojnë kompetencë-vendim reale gjyqësore sipas lëndëve kontestuese qytetare, procedura për falimentim dhe vendimmarrje për përgjegjësi penale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në procedurat penale. Me këtë do të bëhet edhe një hap para për realizimin e qëllimit përfundimtar, kurse kjo është krijimi i gjyqësisë efikase në Republikën e Maqedonisë.

TEKSTI I DISPOZITAVE TË LIGJIT PËR PËRMBARIM QË NDRYSHOHEN DHE PLOTËSOHEN

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen rregullat sipas të cilave përmbarduesit veprojnë për shkak të përmbardimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor që i shqiptohet plotësimin të detyrimit, përveç nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen dhe ndaj përmbardimit të detyrueshëm të vendimit të miratuar në procedurën administruese që shqipton plotësimin e detyrimit me para, përveç nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në përmbardim të anijes dhe të mjetit të fluturimit.

Bazë për përmbardimin dhe fillimin e përmbardimit

Neni 2

- (1) Baza për përmbardim përfaqëson dokumentin përmbardues.
- (2) Përmbardimi fillon me kërkesën nga kreditori.
- (3) Përmbardimi i dokumentit përmbardues mund të zbatohet vetëm te një përmbardues .
- (4) Përmbardimi për shkak të pagesës së dënimeve me të holla dhe shpenzimeve të shqiptuara në procedurat kontestimore, për kundërvajtje, penale dhe administruese, fillon me kërkesë të Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë.

DOKUMENTI PËRMBARUES

Neni 12

- (1) Dokumente përmbarduese janë:
 - 1) vendimi gjyqësor përmbardues dhe balancim gjyqësor ,
 - 2) vendimi përmbardues dhe balancimi në procedurën administruese, nëse i shqiptohen plotësimit të detyrimit me para ,
 - 3) dokumenti përmbardues i noterit ,
 - 3-a) përfundim i përmbarduesit për verifikimin e shpenzimeve të përmbardimit dhe
 - 4) dokumenti tjetër që si dokument përmbardues është paraparë me ligj.
- (2) Vërtetim për përmbardim jep gjykata, përkatësisht organi i cili ka vendosur për kërkesën në shkallë të parë.
- (3) Vërtetimi i pabazë për përmbardimin me aktvendim do ta shfuqizojë e njëjta gjykatë, përkatësisht organ me propozim ose me detyrë zyrtare.

Përmbardim i dokumenteve të noterit

Neni 16

- (1) Dokumenti i noterit është dokument përmbardues, nëse është përmbarduar sipas dispozitës së veçantë që e rregullon përmbardimin e dokumentit të tillë.
- (2) Në bazë të dokumentit të noterit që përmbarduar në një pjesë, përmbardimi do të zbatohet vetëm në atë pjesë.

Neni 238

- (1) Procedurat e filluara për përmbardim deri në ditën e zbatimit të këtij ligji do të përmbardohet sipas Ligjit për procedurë përmbarduese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 53/97, 59/200 dhe 64/2003), më së voni deri më 31 dhjetor 2008.
- (2) Procedurat lidhur me propozimet për përmbardim që i janë parashtruar gjykatës deri në ditën e zbatimit të këtij Ligji, ndërsa nuk kanë filluar, do të zbatohen sipas dispozitave të këtij Ligji.